



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO					
Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo					
Nr. Prot Broj. prot Prot. no	154	Nr. i faq Br. str. No. page	4	Data: Datum: Date:	02.03.2026
ARKIV JARHIU - ARHIVE					
PRISTINA - PRISTINA					

KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS (OIK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, nenit 17, paragrafi 4 dhe nenit 18, paragrafi 2 të Statutit të OIK, si dhe nenit 58 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OIK, në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2026, miraton këtë:

KODI I MIRËSJELLJES PËR KANDIDATËT DHE MBËSHTETËSIT E TYRE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Ky Kod i mirësjelljes ka për qëllim krijimin e kushteve që anëtarët e OIK të zgjedhin përfaqësuesit e tyre përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirëinformuara, në një atmosferë demokratike, me qëllim të përfaqësimit të interesave të anëtarëve në njësitë përkatëse zgjedhore, si dhe të interesave të komunitetit në përgjithësi.

Neni 2

Përkufizimet dhe shkurtesat .

Për qëllim të këtij Kodi të Mirësjelljes, termat dhe shkurtesat e përdorura kanë këtë kuptim:

1. **“OIK”** – Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të Tjerë Shëndetësorë të Kosovës.
2. **“KQZ”** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i OIK-ut, organ përgjegjës për organizimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe vendimmarrjen lidhur me procesin zgjedhor.
3. **“SKQZ”** – Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, strukturë administrative mbështetëse e KQZ-së.
4. **“KNJZ”** – Komisioni i Njësisë Zgjedhore, organ përgjegjës për administrimin e procesit zgjedhor në njësinë zgjedhore përkatëse.
5. **“Kandidat”** – anëtari i OIK-ut i certifikuar nga KQZ për të marrë pjesë në procesin zgjedhor për zgjedhjen e organeve të OIK-ut.

6. **“Mbështetës”** – çdo person fizik apo juridik që mbështet publikisht ose në mënyrë aktive një kandidat gjatë procesit zgjedhor.
7. **“Njësi Zgjedhore”** – bazë territoriale, institucionale ose profesionale e përcaktuar nga KQZ për organizimin e zgjedhjeve dhe përfaqësimin në organet e OIK-ut.
8. **“Vendvotim (VV)”** – hapësira e përcaktuar nga KQZ ose KNJZ për ushtrimin e së drejtës së votës në ditën e zgjedhjeve.
9. **“Proces zgjedhor”** – tërësia e veprimeve që përfshin shpalljen e zgjedhjeve, kandidimin, fushatën zgjedhore, votimin, numërimin e votave, certifikimin dhe shpalljen e rezultateve.
10. **“Organ zgjedhor”** – çdo organ i përfshirë në organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve në OIK, përfshirë KQZ-në dhe KNJZ-të.
11. **“Kodi”** – Kodi i Mirësjelljes për Kandidatët dhe Mbështetësit e Tyre i miratuar nga Kuvendi i OIK-ut.

Neni 3

Përgjegjësitë e kandidatëve dhe mbështetësve të tyre

1. Dispozitat e këtij Kodi janë detyruese për të gjithë kandidatët, mbështetësit e tyre dhe anëtarët e OIK.
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka autoritet ligjor për të vendosur lidhur me pretendimet për shkelje të këtij Kodi dhe për të iniciuar sanksione në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.
3. Kandidatët obligohen t’i informojnë në mënyrë të duhur mbështetësit e tyre për përmbajtjen dhe obligimet që rrjedhin nga ky Kod.
4. Kandidatët ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar shkeljet e këtij Kodi nga ana e mbështetësve të tyre.
5. Kandidatët mbajnë përgjegjësi për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga ata vetë ose nga mbështetësit e tyre.
6. Kandidati ka të drejtë të paraqesë prova pranë KQZ-së që dëshmojnë përpjekjet serioze për të parandaluar dhe/ose dekurajuar mbështetësit e tij nga shkelja e këtij Kodi. Këto prova mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - a) informimin e mbështetësve për dispozitat e këtij Kodi;
 - b) dënimin publik të dhunës, kërcënimeve ose frikësimeve gjatë procesit zgjedhor;
 - c) qortimin publik dhe aktiv të mbështetësve për shkelje të rregullave zgjedhore;
 - d) mungesën e çdo nxitjeje, përkrahjeje apo tolerimi të shkeljeve të rregullave zgjedhore;
 - e) çdo provë tjetër relevante që dëshmon përpjekjet parandaluese të kandidatit.
7. Secili kandidat nënshkruan një deklaratë me të cilën konfirmon se njeh dhe do t’u përmbahet dispozitave të rregullores për zgjedhje dhe këtij Kodi.

Neni 4

Veprimet e ndaluara

1. Gjatë periudhës së kandidimit dhe fushatës zgjedhore, kandidatëve dhe mbështetësve të tyre u ndalohen veprimet si në vijim:
 - a) çrregullimi ose pengimi i fushatës së kandidatëve të tjerë;
 - b) pengimi i anëtarëve dhe punonjësve të institucionit për kryerjen e detyrave të tyre profesionale;
 - c) premtimi i shpërblimeve financiare ose përfitimeve të tjera me qëllim të sigurimit

të mbështetjes;

d) kanosja e kandidatëve të tjerë, mbështetësve të tyre, anëtarëve të OIK ose stafit institucional;

e) nxitja e personave pa të drejtë vote për të votuar;

f) nxitja për votim të shumëfishtë ose votim në emër të personit tjetër;

g) abuzimi me të drejtën e ankesës përmes parashtrësive të rreme ose keqdashëse;

h) përdorimi i gjuhës, simboleve, fotografive ose materialeve që nxisin dhunë, urrejtje apo frikësim;

i) heqja, dëmtimi, mbulimi ose ndryshimi i materialeve zgjedhore të kandidatëve të tjerë.

Neni 5

Frikësimi dhe dhuna gjatë procesit zgjedhor

1. Ndalohet rreptësisht përdorimi ose kërcënimimi me çfarëdo forme dhune nga kandidatët ose mbështetësit e tyre.
2. Asnjë kandidat nuk guxon të inkurajojë, mbështesë apo tolerojë dhunën, kërcënimet ose kanosjet gjatë procesit zgjedhor.
3. Kandidatët obligohen ta organizojnë fushatën zgjedhore në mënyrë që të sigurohet një atmosferë e qetë, e lirë dhe demokratike.

Neni 6

Veprimet e ndaluara për kandidatët me pozita mbikëqyrëse

1. Kandidatët ose mbështetësit e tyre, si dhe çdo anëtar i OIK që ushtron pozitë mbikëqyrëse, nuk guxojnë të shfrytëzojnë funksionin ose resurset institucionale për përfitim elektoral.
2. Asnjë kandidat nuk inkurajon, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor. Secili kandidatë i informon mbështetësit e tij për nevojën për të shmangur një sjellje të tillë.
3. Secili kandidatë obligohet që fushatën zgjedhore ta organizojë në atë mënyrë që një atmosferë e përshtatshme të mbizotërojë gjatë fushatës zgjedhore.

Neni 7

Pranimi i vendimeve dhe rezultateve zgjedhore

1. Kandidatët dhe mbështetësit e tyre obligohen t'i njohin dhe respektojnë vendimet përfundimtare të organeve zgjedhore të OIK.
2. Rezultatet zgjedhore të certifikuar janë të detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në proces.
3. Kandidatët ruajnë të drejtën për ndjekjen e mjeteve juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Sanksionimi i shkeljeve

1. Shkelja e këtij Kodi përbën shkelje të rregullave zgjedhore për të cilën shqiptohen sanksionet e parapra në rregulloren bazë të zgjedhjeve dhe shkarkimit të anëtarëve të organeve të OIK.
2. KQZ i inicion procedurat për shkeljet përkatëse pranë Gjykatës së Nderit.
3. Shkeljet që synojnë ndikimin në rezultatet zgjedhore mund të përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 9

Shkeljet tjera

Për shkeljet zgjedhore që nuk janë të parashikuara shprehimisht në këtë Kod, vendos KQZ.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi dhjetë (10) ditë pas miratimit.

Prishtinë, 27.02.2026



Kryetare e OIK

Nexhmije Gori